REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS
MALISHEVË ... MALIŠEVO

PRANUAR MË: 04.04.2023
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 02/191

**REPUBLIKA E KOSOVËS**

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

---

Kryesuesi i Kuvendit
Nr.02/____
Datë:04.04.2023

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/15, qeshor 2008, bazuar në nenin 53 paragrafi 3, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/21, qeshor 2016", nenit 10 dhe 19, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë:12.11.2008,

Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e tretë (III) të rregullt të mbajtur me datë: 30.03.2023 merr këtë:

## VENDIM

1. Shfuqizohet vendimi Nr.02/71 të datës: 07.02.2023, për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve të reja.

2.Shfuqizimi i vendimit me numër të cekur si më lartë bëhet në pajtim me shkresën e MAPL-së nr-659-2/23 datë:23.02.2023.

3. Për zbatimin e këti vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përmes organeve kompetente.

6.Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi sipas nenit 81 të Ligjit nr.03/040, për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :
MAPL-së
Arkivit të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit
Arbënd Thaqi

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kryesuesi i Kuvendit
Nr.02/ 71
Datë: 07.02.2023

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 40 paragrafi 2 shkronja (d,e), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/ 2008" , në bazë të nenit 10 , nenit 19, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -I- (parë) të rregullt të mbajtur me datë: 30.01.2023 merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR EMËRTIMIN E RRUGËVE TË REJA

1.Me këtë vendim formohet Komisioni për emërtimin e rrugëve të reja.

2.Mbështetur në nenin 1 të këti vendimi Komisioni do të jetë në përbërje prej 7 antarëve:

1.Valon Mazreku-Nisma Socialdemokrate-anëtar
2.Burim Paqarizi-PDK-anëtarë
3. Driton Kastrati -LDK-anëtarë
4. Valon Krasniqi-VV-antarë
5. Donjetë Shijaku –AAK-antarë
6.Blerta Krasniqi -përfaqësues nga zyra e kryetarit
7. Endrit Berisha–përfaqësues nga zyra e kryetarit

3. Për zbatimin e këti vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës përmes Drejtorive përkatëse.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në auteritetin mbikqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008", nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) nr.06/2021 dhe pas shpalljes ne ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :
MAPL-së
Arkivit të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaçi

02 659-2/23
01 23.02.23
PRISHTINË / A

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada – Government**

| | |
|---|---|
| Për: | Ekrem Kastrati, Kryetar i Komunës së Malishevës<br>Argjend Thaqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës |
| Kopje: | Elbert Krasniqi, Minister i MAPL<br>Venera Çerkini, Zëvendësuese e Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL |
| Përmes: | Liburn Aliu, Ministër i MMPHI<br><br>Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI |
| Nga: | Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor Nr. ML-37/23<br>Date: 20.02.2023 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit |
| Lënda: | MMPHI nuk është kompetente për shqyrtimin e aktit |
| Lloji i aktit: | Vendimi Nr.02/71 për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve të reja, miratuar nga KK Malishevë. |

I nderuari Kryetar, Kastrati,
I nderuara Kryesues, Thaqi,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me datë 10.02.2023, ka pranuar nga MAPL Vendimin Nr.02/71 për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve të reja, miratuar nga KK Malishevë, datë 30.01.2023.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit Nr.02/71 për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve të reja, miratuar nga KK Malishevë dhe në pajtim më Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, konstatoi:
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nuk është kompetente për shqyrtimin e këtij akti komunal pasi që dispozitat e Ligjit Nr.04-L/013 për Kadastër, Ligji mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 2002/5 mbi Themelimin e Regjistrit të të drejtave në pronën e Paluajtshme dhe Ligjit Nr.04/L-071 për Sistemin e Adresave, nuk e parashohin formimin e një komisioni të tillë.